



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

---

**Intervistë e Ministrit Sadri Ferati dhënë gazetës "Express"**

**Projekti i integrimit**

**Qeveria po bën përgatitjet për krijimin e 5+1 komunave të reja me shumicë serbe. Ato i legjitimon vetëm dalja e serbëve në zgjedhjet lokale. Kjo është një mundësi që komuniteti serb nuk duhet ta humbë. Kosova është e interesuar për integrimin e të gjitha komuniteteve dhe është e vendosur për të zbatuar obligimet që ka marrë. Shumica shqiptare është e vetëdijshme për rëndësinë që ka ky projekt. Ministri i Pushtetit Lokal, Sadri Ferati, flet për Express.**



Institucionet e Kosovës do të provojnë të zbatojnë decentralizimin e paraparë me pakon e Ahtisaarit, që është sfida më e madhe e këtij plani, dhe koncesioni më i madh që kanë bërë shqiptarët gjatë bisedimeve për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Deri më tash janë bërë përgatitje të mëdha, por rezultatet praktike do të shihen gjatë muajve të ardhshëm dhe përfundimisht me mbajtjen e zgjedhjeve lokale, përmes të cilave do duhej të funksionalizohen dhe legjitimohen pesë komuna të reja me shumicë serbe. Edhe pse nuk ka qenë pjesëmarrës në bisedimet e Vjenës, njeriu i cili ka barrën kryesore dhe obligimin për zbatimin e këtij projekti është Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal Sadri Ferati. Në fund të prillit mbyllet konkursi që është hapur për gjetjen e atyre që do të bëjnë pjesë në

gjashtë Ekipe Përgatitore për krijimin komunave e reja: Graçanicë, Klokot, Ranillug, Partesh, Mitrovica veriore si dhe zgjerimi i Artanës. Ky do jetë testi i parë për të parë vullnetin e komunitetit serb për pjesëmarrje në projektin e decentralizimit.

**“Aty ku nuk ka interesim të kënaqshëm, por edhe kualitet, do të bëhet përsëritja e konkursit”,** ka thënë Ministri Ferati.

Ekipet kanë detyrë të përgatisin gjashtë lokalitetet për zgjedhjet e ardhshme lokale, të sensibilizojnë dhe propagandojnë në dobi të implementimit të decentralizimit, të bashkëpunojnë me një administratë minimale që do të instalohet dhe çështje tjera.

**“Ekipi i bënë të gjitha veprimet që me rastin e mbajtje së zgjedhjeve të lira, komuna të bëhet sa më shpejt funksionale, që faza e tranzicionit të mos jetë shumë e gjatë”,** ka thënë Ferati.

Zgjedhjet e ardhshme lokale, që do duhet të mbahen këtë vjeshtë, do të jenë testi kryesor për fatin e secilës nga komunat e reja. Shumica e komunitetit serb, të nxitur nga Beogradi zyrtar, kanë bojkotuar zgjedhjet e fundit në Kosovë.

Ministri Ferati nuk jep përgjigje se sa do të duhej të ishte përqindja e pjesëmarrjes së serbëve në zgjedhje në mënyrë që komuna e re të jetë legjitime.

**“Sot për sot nuk e kam përgjigjen. Kam idetë e mia për të vlerësuar se mbi cilën përqindje të vullnetit të qytetarëve do të duhej të instalohet një komunë, por është çështje e vendimeve që do të marrin edhe liderët edhe partnerët ndërkombëtar, por edhe vetë komuniteti serb që bashkërisht të vendosim sikurse edhe te ekipet përgatitore”.**

Lidhur me zgjedhjet e ardhshme lokale, ka pasur indikacione se ato mund të shtyhen me shpresë që vitin e ardhshëm serbët të jenë më të vullnetshëm për të marrë pjesë në këtë proces.

Mirëpo, Ministri Ferati nuk beson se mund të vihet në pikëpyetje mbajtja e zgjedhjeve. “Na mbetet me shpreh keqardhje nëse ndonjë lokalitet nuk e shfrytëzon këtë mundësi dhe i prolongohet ajo mundësi e tillë, por, në tërësi, nuk do të mund ta rrezikojë pjesën tjetër të procesit, në përgjithësi, edhe si zgjedhje edhe si funksion”.

Ferati dhe zyrtarë tjerë kosovarë dhe ndërkombëtarë kanë pasur shumë takime të drejtpërdrejta me komunitetin serb ku parashihet krijimi i komunave të reja.

Ai ka dëgjuar shqetësimet e serbëve rreth procesit të decentralizimit. Ato janë të motiveve të ndryshme. Një pjesë e serbëve kanë frikë se mund të humbin beneficionet nga Beogradi nëse përshihen brenda kornizës ligjore të Kosovës. Serbët tjerë, të kontrolluar nga Beogradi zyrtar, dëshirojnë të pengojnë këtë proces për të mos lejuar funksionalizimin e plotë të shoqërisë dhe shtetit të Kosovës.

**“Në disa lokalitete interesimi për decentralizim është më i shtuar, në disa më i vogël. Por, Interesimi është më i shtuar se që ishte 7-8 muaj më parë”,** ka thënë ai.

Ministri Ferati thotë se serbët nuk kanë pasur argumentet të kritikojnë kualitetin e projektit të decentralizimit.

**“Sepse një grup fshatrash me 5 mijë ose 6 mijë banorë do të kenë një komunë me kompetenca sa Prishtina, derisa nuk rregullohet me ligjin e ri, apo Prizreni, Mitrovica, Gjakova. Ka kompetenca, autonomi dhe fuqi në menaxhim ma të madh se një komunë 150 mijë banorësh në Serbi. Ky është edhe një faktorizim i plotë që ju ndodh atyre me këtë projekt”.**

Me planin e Ahtisaarit, në komunën në veri të Mitrovicës lejohet themelimi i një universiteti publik në gjuhën serb, i cili tashmë ekziston, por si strukturë paralele. Kompetenca në fushën e arsimit sekondar do të kenë Graçanica, Shtërpca dhe Mitrovica veriore. Të gjitha komunat e reja do të marrin përgjegjësi në fushën e trashëgimisë fetare dhe kulturore dhe për caktimin e komandantit të stacionit policor. Do të kenë edhe lidhje të veçanta me Beogradin.

Kompromisi i negociatorëve kosovarë rreth decentralizimit gjatë procesit të bisedimeve të Vjenës nuk është pritur mirë nga shqiptarët.

Ka pasur vlerësime se pas krijimit të këtyre komunave të reja me shumicë serbe, pushteti do të keqpërdoret dhe Kosova do të fitojë edhe disa “Shtërpca” të reja ku nuk zbatohen ligjet kosovare. Ministri i Pushtetit Lokal i përmend edhe vetë këto shqetësime të shqiptarëve, por beson se nuk do të ndodh një keqpërdorim i tillë.

Ai thekson se ndaj shkeljeve ligjore do të kishte reagim të organeve kompetente.

**“Qytetarët e komunitetit serb janë lodhur. Ata e dinë se çdo devijim nuk do të ishte në dobi të tyre. Më nuk do të kishte mirëkuptim për gjendjen e tyre, por do të denoncoheshin edhe nga bashkësia ndërkombëtare, edhe nga institucionet e Kosovës se janë ata që vërtet po e ngadalësojnë integrimin e tyre, dhe po e keqpërdorin ligjin”,** ka thënë Ferati.

Ai vlerëson se shqiptarët tashmë janë të vetëdijshëm për rëndësinë që ka decentralizimi dhe kanë krijuar një besim se implementimi, përkundër që nuk është pëlqyer në fillim, do të mund të lëvizë për të mirë gjendjen aktuale në enklavat serbe dhe të normalizojë jetën.

Ministri beson fuqishëm se sukcesi në projektin e decentralizimit do të eliminonte strukturat paralele

në territoret e komunave të reja. Sipas tij, shumica e serbëve janë të irrituar nga këto struktura dhe nuk shohin të ardhme nga to.

Institucionet kosovare po bëjnë çmos që të jetësohet pjesa më e ndjeshme e Pakos së Ahtisaarit.

**“Ne kemi bërë tërë atë që kemi mundur dhe kemi shtrirë dorën si institucione. Mundësia e instalimit të komunës së re është edhe një e drejtë kushtetuese dhe ligjore por është edhe një shans që ju jepet. Neve na mbetet të dëshirojmë që qytetarët ta shfrytëzojnë këtë rast”,** ka thënë Ferati.

Zbatimi i decentralizimit nuk ka kosto të madhe deri në mbajtjen e zgjedhjeve lokale. Por, për projektin e përgjithshëm, me investime kapitale nëpër komuna dhe gjithçka tjetër, është vlerësuar se janë të nevojshme rreth 30 milionë euro, të cilat do të sigurohen nga institucionet e Kosovës dhe donatorët ndërkombëtarë.

**Intervistoni Bekim Greiçevci**